



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 124 Prot.

Datë 27.01.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Pogradec

Drejtuar: Z. Eduart KAPRI
Kryetar
Bashkia Pogradec

I nderuar Z. Kapri,

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 138 Prot., datë 12.01.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 45 Prot., datë 16.01.2017 me lëndë “Kërkesë për Aktin e Përputhshmërisë, për Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Pogradec”, Ju bëjmë me dije se:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, pas verifikimeve në Regjistrin e Integruar të Territorit, konstatoi se Bashkia Pogradec nuk ka botuar materialet të përditësuara të dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor në një folder të ri, objekt shqyrtimi nga ana Jonë.

Bazuar në Nenin 11 “Botimi në Regjistrin e Integruar të Territorit”, të Rregullores së Planifikimit, ju sjellim në vëmendje detyrimin e botimit në Regjistrin e Integruar të Territorit të materialit të plotë të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Pogradec.

Referuar nenit 57 “Miratimi i PPV-së”, pika 8, gërma a) të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, bëjmë me dije se nevojitet dokumentacioni i plotë, për nisjen e shqyrtimit të dokumenteve të PPV Bashkia Pogradec dhe për dhënien e Aktit të Përputhshmërisë.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi punoi:
B.Laci, M.Kashnica
Datë 26.01.2017
Nr. Kopje:2